

## ÇFARË MUND TË BËSH TI NËSE NDJEHESH I/E DISKRIMINUAR?

### T'I DREJTOHESH KOMITETIT TË HELSINKIT PËR TË DREJTAT E NJERIUT NË:

Rr. „Naum Naumovski Borçe” Nr. 83 në Shkup  
Telefon për kontakt: + 389 (0) 2 3119 073  
+ 389 (0) 72 278 436  
email: helkom@mhc.org.mk

### TË PARAQESËSH NJË PARASHTRËSË PRANË KOMISIONIT PËR PARANDALIMIN DHE MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Parashtresa mund të paraqitet në faqen e internetit [www.kzd.mk](http://www.kzd.mk), ose me shkrim në adresën e Komisionit „Kej Dimitar Vllahov” bb Shkup.

Parashtresën mund ta paraqesësh brenda **6 muajve** nga zbulimi i aktit të diskriminimit, dhe jo më vonë se **1 vit** pas kryerjes së shkeljes.

Komisioni duhet të sjellë vendim brenda **60 ditëve** nga dita e paraqitjes së parashtresës.

### TË PARAQESËSH NJË PARASHTRËSË PRANË AVOKATIT TË POPULLIT

Parashtresën mund ta paraqesësh me shkrim (personalisht ose me postë) në adresën Rr. „Makedonija” Nr.19 Shkup, gojarisht me procesverbal në zyrat e Avokatit të Popullit, në numrin e telefonit: +389(0)02 3129 335, ose me email: [contact@ombudsman.mk](mailto:contact@ombudsman.mk).

### TË PARAQESËSH NJË PADI PRANË GJYKATËS KOMPETENTE

Me ngritjen e një procesi gjyqësor, mund t'i kërkoesh gjykatës ta vërtetojë shkeljen të së drejtës për trajtimin e barabartë, ndalim të veprimit, kompensim të dëmit ose publikim të aktgjykimit nëpër mediat.

Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut ofron ndihme parësore juridike për qytetarët.

E drejta e ndihmes parësore juridike i përket çdo personi fizik me adresë ose vendbanim në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Ndihma parësore juridike i ofrohet personit të interesuar me qëllim që t'i shpjegohet natyra e çështjes ose t'i ndihmohet të kuptojë nëse problemi përfaqëson një çështje juridike, nëse ai përfshihet në kornizën e shërbimeve juridike të ofruara nga autoritetet e përcaktuara, si dhe llojet e ndihmave juridike të cilat janë më të përshtatshme për personin.

## ME NDIHMËN PARËSORE JURIDIKE JU MERRNI:

- ✓ TË DHËNA TË PËRGJITHSHME JURIDIKE
- ✓ KËSHILLA TË PËRGJITHSHME JURIDIKE
- ✓ NDIHMË GJATË PLOTËSIMIT TË FORMULARËVE
- ✓ NDIHMË GJATË PLOTËSIMIT TË KËRKESËS PËR NDIHMË DYTËSORE JURIDIKE
- ✓ PËRGATITJE TË PARASHTRËSËS PRANË KOMISIONIT PËR PARANDALIMIN DHE MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI, AVOKATIT TË POPULLIT DHE PËRGATITJE TË NJË KËRKESE PËR MBROJTJE PRANË GJYKATËS KUSHTETUESE.



Ky produkt është përgatitur në kuadër të programit “Bazat e së ardhmes” i financuar nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar me mbështetjen e Ambasadës Britanike Shkup. Përmbajtja e këtij publikimi nuk i pasqyron domosdoshmërisht qëndrimin ose mendimet e Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar.



# PËRFSHIRJA PA PENGESA

Të dhëna mbi qasjen në përdorimin e ndihmës juridike për fëmijë dhe persona me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre



NAUM NAUMOVSKI  
BORÇE 83/1, 1000 SHKUP  
HELKOM@MHC.ORG.MK

+389 (0) 2 3119 073  
+389 (0) 72 278 436  
[WWW.MHC.ORG.MK](http://WWW.MHC.ORG.MK)

1



A mundesh **vetë ta përdorësh** transportin publik?

A të është **refuzuar** shërbimi shëndetësor?



2

3



A të është **mundësuar ta regjistrohsh** fëmijën tënde në shkollë të rregullt?

A ofron shkolla **mbështetje përkatëse** për përfshirjen e fëmijës tënde në arsimin e rregullt?



4

5



A mundesh **papenguar të hysh brenda** institucioneve publike?

A ke vështirësi në vendin e punës për shkak se **kujdesesh për ndonjë fëmijë ose person me aftësi të kufizuara**?



6



## ÇFARË ËSHTË DISKRIMINIMI?

Diskriminimi do të thotë çdo dallim, përjashtim, kufizim ose përparësi në bazë diskriminuuese, qoftë e kryer apo jo, qëllimi ose rezultati i cilave është parandalimi, kufizimi, njohja, gëzimi ose ushtrimi i të drejtave dhe lirive të një personi ose grupi të caktuar në bazë të barabartë me të tjerët. Kjo i përfshin të gjitha format e diskriminimit, duke i përfshirë dhe çmundësimin e përshatjes përkatëse dhe çmundësimin e qasjes dhe disponueshmërisë së infrastrukturës, mallrave dhe shërbimeve.

## BAZAT E DISKRIMINIMIT

→ RACA

→ NGYRA E LËKURËS

→ KOMBËSIA OSE PËRKATËSIA ETNIKE

→ SEKSI

→ GJINIA

→ ORIENTIMI SEKSUAL

→ IDENTITETI GJINOR

→ PËRKATËSIA NË NJË GRUP TË MARGJINALIZUAR

GJUHA ←

SHTETËSIA ←

ORIGJINA SHOQËRORE ←

SHKOLLIMI ←

FEJA OSE BESIMI FETAR ←

BINDJA POLITIKE ←

BINDJE TË TJERA ←

**AFTËSITË E KUFIZUARA** ←

MOSHA ←

GJENDJA FAMILIARE OSE MARTESORE ←

STATUSI I PASURISË ←

GJENDJA SHËNDETËSORE ←

STATUSI PERSONAL DHE SHOQËROR ←

OSE

ÇFARËDO BAZE TJETËR ←

QË NJË PERSON TË KONSIDEROHET VIKTIMË E DISKRIMINIMIT, AI JO DOMOSDOSHMËRISHT DUHET TË BAZOHET DREJTPËRDREJT NË NDONJË NGA ARSYET E MËSIPËRME. PRANDAJ, NDALIMI I DISKRIMINIMIT TË DREJTPËRDREJTË NUK KUFIZOHET VETËM NË PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA, POR I PËRFSHIN EDHE PERSONAT E PREKUR NGA GJENDJA E TYRE, PËRKATËSISHT ANËTARËT E FAMILJES, KUJDESTARËT DHE PERSONAT E TJERË TË CILËT KUJDESEN PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA.